NJË DITË QË MBAHET MEND NË "MUZEUN E ARTIT" ME EMRIN VOSKOPOJË



"DISA NGA AFRESKET MË MADHËSHTORE MUND TË GJENDEN NË 'PARIS-IN E BALLKANIT'"

Në dhjetor të vitit 2022, revista amerikane më prestigjioze në botë, National Geographic, botoi një artikull të Ben O'Donnell-it me titull:

"DISA NGA AFRESKET MË MADHËSHTORE MUND TË GJENDEN NË 'PARIS-IN E BALLKANIT'",

Kushtuar afreskeve dhe pikturave murale të kishave të Voskopojës.
Edhe pse e kam vizituar disa herë Voskopojën, ky shkrim – ndër më domethënësit e viteve të fundit për trashëgiminë kulturore shqiptare – më shtyu të rikthehem aty përsëri aty, këtë herë me një qëllim të qartë: Të shihja më me vëmëndje afresket që kishin zënë vend në faqet e revistës.
Këtë herë u ndala më së shumti te Kisha e Shën Kollit, një nga objektet e përmendura në artikull. Përballë afreskave të shekullit XVIII, të krijuara nga mjeshtrat Zografi dhe David Selenica, ndjeva kontrastin e fortë mes madhështisë së një epoke dhe rrënimit që sollën kohërat.

Aty ku dikur arti fliste me një gjuhë universale për shpirtin njerëzor, sot shfaqen afreske të gërryera, ikona të thyera dhe mure të heshtura.

Megjithatë, edhe pse të dëmtuara, ato mbeten dëshmi të jashtëzakonshme të guximit, dijes dhe besimit të shqiptarëve të asaj kohe.

Fotografitë që bëra e tregojnë qartë këtë kontrast dramatik: Madhështinë e artit dhe faktin që këto vepra i shpëtuan sundimit osman, por jo dëmtimit dhe degradimit të shkaktuar gjatë periudhës komuniste dhe shtetit ateist.

Trashëgimia e Voskopojës nuk është vetëm një koleksion i jashtëzakonshëm veprash artistike. Më shumë se aq, ajo është testament i identitetit tonë kombëtar.

Shtysë për vajtjen time atje këtë herë ishte edhe fakti se ky artikull plotëson kollanën e shkrimeve për Shqipërinë. Ato të mëparshmet i pata përmbledhur në librin tim të botuar në vitin 2006,

“SHQIPTARËT – LISA MBI TRUALLIN ILIR”,

ku përmblodha çdo shkrim që National Geographic kishte botuar për shqiptarët nga viti 1908 deri më 2003.

Shqipëria u përmend për herë të parë aty më 1908, e më pas në vitet 1909, 1912 e 1913. Artikulli i parë i plotë, i ilustruar dhe me informacion të pasur, u botua në gusht 1918 nga Gjeneral Brigade amerikani George P. Scriven me titullin "Vëzhgime të kohëve të fundit në Shqipëri". Në dhjetor të atij viti shqiptarët u përfshinë gjerësisht në një artikull mbi "Racat e Evropës".

Më tej erdhën kontributet e Luigi Villarit me "Racat dhe fetë në Maqedoni", shkrimi i Melville Chater "Mbretëria më e re e Evropës" (1931), dhe pastaj artikulli tronditës i Sami Kohen dhe Hasan Biber "Shqipëria e vetme kundër gjithë botës" (1981), si dhe shkrime të tjera që pasqyruan dramën dhe forcën e shqiptarëve, si Kenneth C. Danforth: "Jugosllavia – një shtëpi e përçarë", për aparthejd-in sllav ndaj shqiptarëve të Kosovës; Dusko Doder: "Shqipëria i hap dyert" (1992); Prit Veselind: "Shqiptarët – një popull i ç'bërë" (2002).

Artikulli per Voskopjwn e vërteton edhe një herë vëmendjen e kësaj reviste për ne shqiptarët

Shenim:

Ju lutem pasi të shikoni fotot që po postoj, klikoni në linkun e revistës dhe shikoni fotografitë e saj të cila janë të mbrojtura nga e drejta e autorit.

https://www.nationalgeographic.com/travel/article/albania-historic-churches-rare-frescoes?fbclid=IwY2xjawMdhGxleHRuA2FlbQIxMQABHoEhIrpAC8bynnNIgrzATfj07TIkrpw47Q_r0lGAmXBXTlJHRwYgLNw-qKx5_aem_2IVI7Cyut8Aoe1YC2PAT9g







MAL BERISHA
SHQIPTARËT,
LISA
MBI
TRUALLIN
ILIR
NIË SHEKULL VLERËSIMESH
TË SHTYPIT AMERIKAN
PËR SHQIPTARËT DHE SHQIPËRINË


VOLUME LX
NUMBER ONE
THE NATIONAL
GEOGRAPHIC
MAGAZINE
JULY, 1931
CONTENTS
THIRTY-TWO PAGES OF ILLUSTRATIONS IN FULL COLOR
Konka Risumgongba, Holy Mountain of the Outlaws
With 27 Illustrations
JOSEPH F. ROCK
With the Devil Dancers of China and Tibet
40 Natural Color Photographs
The Most Famous Battle Field in America
With 16 Natural Color Photographs
Into the Land of the Chipmunk
With 36 Illustrations
RUTH ALEXANDER NICHOLS
Unearthing America's Ancient History
With 27 Illustrations
SYLVANUS GRISWOLD MORLEY
PUBLISHED BY THE
NATIONAL GEOGRAPHIC SOCIETY
HUBBARD MEMORIAL HALL
WASHINGTON, D.C.
$5.00 A YEAR
50c THE COPY